

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Qehlibare Glloga datëlindja 1966, e bija e Rizait dhe Ganimetes, banuese në Durrës, lagjja nr.14, Shkozë, e martuar me dy fëmijë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit Ali Glloga, në bazë të nenit 15 të Kodit Civil dhe nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Më 23 nëntor 1995, bashkëshorti im Ali Glloga është larguar nga shtëpia për të shkuar me skaf në Itali si refugjat. Që nga ajo ditë nuk dimë asgjë për të. Jemi interesuar për të marrë vesh nëse mbërriti në Itali, por askush nuk di gjë. Ditën e largimit të Aliut morrëm vesh nga gazetatat se ishte mbytur një skaf dhe ishte gjetur vetëm një person i vdekur dhe 17 të tjerë ishin zhdukur, por nuk e dimë nëse ishte me ta edhe bashkëshorti im Aliu. është fakt se që nga ajo ditë e deri më tani nuk kemi asnjë lajm për të. Janë interesuar edhe familjarët, edhe të afërmit e tij, po nuk kanë asnjë lajm për Aliun.

Kërkoj që, konform ligjit, bashkëshorti im Ali Glloga të shpallet i zhdukur.

KËRKUESJA
Qehlibare Glloga